


| | | |
|---|---|---|
|  | <p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Podujevës Opština Podujevo –Municipality of Podujeva</p> |  |
|---|---|---|

NJOFTIM I KËRKESËS PËR KUALIFIKIM KONCESION

Sipas Nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-045 të Ligjit për Partneritet Publiko Privat

Data e përgatitjes së njoftimit: 24/04/2023

| | | | | | | | | | |
|---------------------|------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Nr. i PPP-se | 615 | 2 | 3 | 0 | 0 | 1 | 5 | 1 | 2 |
|---------------------|------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip

Serbisht

Anglisht

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---------------------------|--|
| Emri zyrtar: KOMUNA E PODUJEVË | | |
| Adresa Postare: NUHI GASHI | | |
| Qyteti: PODUJEVË | Kodi postar: 11000 | Vendi: PODUJEVË |
| Personi kontaktues: RASIM FEJZA | | Telefoni: 038 200 41 021 |
| Email: prokurimi.podujeva@rks-gov.net ; | | Faksi: <i>n/a</i> |
| Adresa e Internetit (<i>nëse aplikohet</i>): | | https:// https://kk.rks-gov.net/podujeve |

Autoriteti kontraktues kryen koncesione në emër të autoriteteve të tjera publike

Po

Jo

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Publike në emër të të cilit ju do të jeni Autoritet Kontraktues

NENI II: PËRSHKRIM I SHKURTËR I KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: PPP - Ndërtimi i parkingut nëntokësor

| |
|--|
| <p>II.1.2) Forma e PPP-së</p> <p>X PPP Kontraktuale</p> <p><input type="checkbox"/> Kontratë Publike</p> <p>X Koncesion</p> <p><input type="checkbox"/> Koncesion</p> <p>X Koncesion i Punëve</p> <p><input type="checkbox"/> Koncesion i Shërbimeve</p> <p><input type="checkbox"/> PPP Institucionale</p> |
| <p>II.1.3) Përshkrim i shkurtër i kontratës</p> <p>Projektimi, ndërtimi, financimi, operimi dhe bartja e parkingut nëntokësor te Komuna e Re</p> |
| <p>II.1.4) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45000000-7.</p> |
| <p>II.2) FUSHËVEPRIMI I PËRGJITHSHËM I KONTRATËS</p> <p>Komuna e Podujevës kërkon parashtrimin e deklaratave për kualifikim me qëllim të përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe konzorciumeve të operatorëve ekonomik që posedojnë kapacitetet e duhura ligjore, teknike dhe financiare për të marrë pjesë në procedurën konkurruese të tenderit për projektimin, ndërtimin, financimin, operimin dhe bartjen e Parkingut Nëntokësor duke përfshirë por pa qenë e domosdoshme edhe objekte afariste (“Objekti”) në Lokacionin te Komuna e Re në Podujevë përmes Partneritetit-Publiko-Privat (‘PPP’).</p> |
| <p>II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM</p> <p>Kohëzgjatja e kontratës në vite 30 vite</p> |

NENI III: KRITERET LIGJORE, TEKNIKE E FINANCIARE DHE PESHA RELEVANTE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

| |
|--|
| <p>III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p><i>Nëse po</i>, vlera e sigurisë së ekzekutimit kërkohet në shumën 290,000.00 € (dyqindënëntëdhjetëmijë), me periudhë të vlefshmërisë prej 30 vite</p> |
| <p>III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t’u jepet kontrata (nëse aplikohet):</p> <p>Nga Ofertuesi i Përzgjedhur do të kërkohet të themelojë një subjekt të pavarur juridik të inkuorporuar sipas ligjeve të Kosovës, para formalizimit të Kontratës së Koncesionit. Subjekti juridik në fjalë do të ketë si qëllim të vetëm përbushjen e obligimeve të paraqitura në Kontratën e Koncesionit .</p> |

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po

Jo

III.2) KUSHTET PËR KUALIFIKIM

III.2.1) Kriteret Ligjore:

1. Ofertuesi Potencial ose në rast të Konzorciumit, secili anëtar i Konzorciumit, duhet të dëshmojë se ka plotësuar kushtet e përshtatshmërisë, të cilat janë paraqitur në nenin 65 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe në nenin 27 të Ligjit Nr. 04/L-045 për partneritet publiko-privat.
2. Ofertuesi Potencial dhe anëtarët individual të Konzorciumit Ofertues, duhet të dëshmojnë se ata janë subjekt korporativ, financiarisht i pavarur nga çfarëdo organizate buxhetore ose procesi vendim-marrës qeveritar.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklaratë të dhënë nën betim që dorëzohet nga secili Ofertues Potencial, ose në rast të Konzorciumit, nga secili anëtar i Konzorciumit, e cila vërteton se i plotëson kushtet e përshtatshmërisë - **Shtojca 3.C**
2. Ofertuesi potencial dhe secili anëtar individual i konzorciumit duhet të dorëzojë një deklaratë të dhënë nën betim ku konfirmohet që ai është subjekt korporativ që i jep llogari vetës, buxheti i së cilit është tërësisht i pavarur nga buxheti qeveritar. **Shtojca 3.D.1**

III.2.3) Kriteret Teknike

1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme (objekte afariste – ndërtimore, rrugë, kanalizime, ujësjellës) ku së paku 2 (dy) nga projektet të ngjajshme të kërkuara në 3(tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Kërkesës për Kualifikim) të jenë në vlerë jo më të vogël se 3,000,000.00€
2. Lista e stafit profesionale të ekspertëve të cilët do të angazhohen për projektin e lartcekur, njohuri, eksperiencë dhe kualifikim përkatës nga lëmia arkitekturore, ndërtimtari, menaxhmentit të punëve ndërtimore.
3. Lista e punëtorëve për tre vitet e fundit, minimumi 20
4. Një listë ku janë të paraqitura pajisjet motorike

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve
2. Lista e stafit profesional duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE, Për stafin profesional OE duhet të ofroj dëshmi: cv, kopjen e diplomës universitare të noterizuar ose nga origjinali (noterizimi të mos jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e kërkesës për Kualifikim) apo nëse OE i ka të regjistruar në listën e pagave në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka nevojë të noterizohen, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt atëherë marrëveshja duhet të jetë kopje e noterizuar nga origjinali.
AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojnë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara.
3. Kontratat e punës ose parakontratat valide në kohëzgjatje të projektit
4. OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke i bashkëngjitur, librezat për automjete të cilat regjistrohen dhe dud-faturë për pajisjet tjera ose dëshmi mbi pronësinë

(apo të marrjes me qira) të mjeteve

III.2.4) Kriteret Financiare

1. Ofertuesi potencial duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë jo më pak se 2,500,000.00€
2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose qasje në kredi.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur
2. Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga Institucioni bankar që dëshmon se OE i ka mjetet financiare në dispozicion lidhur me këtë projekt ose qasje në kredi

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

X E kufizuar

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1)

Publikime tjera (nëse aplikohen): N/A

IV.3.2) Kushtet për marrjen e dokumenteve par para-kualifikimit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dokumentet e para-kualifikimit: data **17.05.2023**

Dokumentet me **Po** **Jo** pagesë

IV.3.3) Afati i fundit për pranim të aplikacioneve:

data 26.05.2023 koha 14:00 vendi - zyra e prokurimit nr. 55

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po **Jo**

Do të kërkohet gjatë fazës së Kërkesës për Propozim (KPP)

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: 120 dite pas afatit të dorëzimit

IV.3.6) Takimi për hapjen e aplikacioneve:

data 26.05.2023 koha 14:30 zyra e prokurimit nr. 55

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues sipas Nenit VI.8

të kësaj Kontrate, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.1.1) ADRESA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

| | |
|---|---------------------|
| Emri zyrtar: Organi Shqyrtues i Prokurimit | |
| Adresa e OSHP: Rr. "MIGJENI" (ish-Banka e Lublanës, Kati V-të), Prishtinë, Kosovë | |
| Qyteti: Prishtinë | Kodi postar: 10 000 |
| Adresa elektronike (nëse aplikohet): | |
| Personi kontaktues: | E-mail: |
| Telefoni: 038 213 378 | Faksi: |

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejojnë gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.